




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Bi Prot. 01-2099/14
Nr. Prot. Broj. stranica 03	Data Datum 10-06-2014
Nr. pages	
PUSHINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	10.06.2014
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Gani NEKAJ Kryesues i Departamentit të Prokurimit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale
CC:	z. Midin BOJAXHIU Drejtor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Përpilimi i një planshete të hartës gjeologjike të Kosovës "



I nderuari z. NEKAJ ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “ Përpilimi i një planshete të hartës gjeologjike të Kosovës “ me nr. të prokurimit 318-14-010-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e tenderit me titull “Përpilimi i një planshete të hartës gjeologjike të Kosovës“ me nr. të prokurimit 318-14-010-221 i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit, pranë Komisionit të Pavarur për miniera dhe minerale ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull “ Përpilimi i një planshete të hartës gjeologjike të Kosovës “ me nr. prokurimi:318-14-010-221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 29.04.2014, në Procedurë të Hapur. Gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të dokumentacionit lidhur me këtë procedurë të prokurimit AKK ka konstatuar të gjeturat si në vijim:

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka marr pjesë në cilësinë e monitoruesit në vlerësimin e tenderit me titull “ Përpilimi i një planshete të hartës gjeologjike të Kosovës “. Gjatë monitorimit të këtij aktiviteti të prokurimit është konstatuar se asnjëri nga Operatorët ekonomik që kanë tenderuar për këtë kontratë nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbushin disa nga kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 9 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 2 OE.

Tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit **Autoriteti kontraktues ka kërkuar listën e kontratave kryesore të shërbimeve të operatorit ekonomik.** Autoriteti kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkojë, kontrata dhe referenca për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorëve ekonomik. Në qoftë se Autoriteti kontraktues kërkon kontrata dhe referenca për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të OE-ve, atëherë detyrimisht këto kontrata dhe referenca duhet ti kërkojë në tri vitet e fundit në pajtim me Udhëzimin administrativ nr.02/2014 të KRPP-së.

Autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ndërsa si nën kritere i ka caktuar **çmimin të cilit i ka caktuar peshë prej 50 %, Arsyeshmëria 15 pikë, Strategjia 15 pikë, këtë nën kriter e ka peshuar me 30 %, ndërsa si nën kriter të tretë e ka caktuar Eksperiencën e projekt menaxherit në kryerjen e punëve të ngjashme të cilin e ka peshuar me 20 %.** Autoriteti kontraktues duhet të këtë kujdes që në rast se përcaktohet për këtë kriter për dhënie të kontratës të caktoj nën kritere të qarta, precize dhe të cilat janë të matshme.

Komisioni për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave të të dy Operatorëve Ekonomik që kanë ofertuar për këtë tender konstatoi dhe erdhi në përfundim se asnjëri nga Operatorët Ekonomik që kanë tenderuar për këtë kontratë nuk janë të përgjegjshëm dhe meqenëse nuk ka tenderë të përgjegjshëm rekomandoi anulimin e këtij aktiviteti të Prokurimit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit kërkon që në rast të ri-tenderimit të këtij aktiviteti të prokurimit Autoriteti kontraktues duhet ti marrë për bazë rekomandimet siç janë theksuar si më lartë.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja

Me respekt !